



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data	
Nr. Prot	

RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN
PËR

“PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.11, DATË 25.03.2021, TË KOMISIONIT RREGULLATOR, “PËR MËNYRËN E NGRITJES, ORGANIZIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË KOMISIONIT TË QENDRËS SË VOTIMIT DHE ZHVILLIMIT TË ZGJEDHJEVE NË QENDRËN E VOTIMIT”, TË NDRYSHUAR”

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI

Referuar nenit 20, pika 1, shkronjat “e” dhe “ë” dhe nenit 22, pikat 1 dhe 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikohet kompetenca e Komisionit Rregullator për të shqyrtuar dhe miratuar projektakte me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e KQZ-së ose nga anëtarët e tij, për përdorimin e sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë së informacionit për mbulimin e aspekteve apo procedurave të veçanta të procesit zgjedhor, ose heqjen e tyre nga përdorimi.

II. PËRMBLEDHJE SHPIEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Vendimi nr.11/2021 ka si qëllim organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Qendrës së Votimit. Objekti i vendimi është përcaktimi i rregullave për ngritjen, organizimin, funksionimin e KQV-së, marrjen e vendimeve, dhe për zhvillimin e zgjedhjeve në qendrën e votimit.

Projektvendimi i propozuar adreson një sërë çështjesh që kanë të bëjnë me mirëfunksionimin e procesit të zgjedhjeve në qendrën e votimit.

Shfuqizimi i shkronjës “d” të pikës pikës 2, të nenit 10 adreson rekomandimin nr. 7 të OSBE ODIHR për zgjedhjet e datës 25 prill 2021 sipas së cilës “Për të garantuar sigurinë juridike dhe administrimin efikas të zgjedhjeve, aktet e detyrueshme nënligjore duhet të jenë në përputhje me legjislacionin primar dhe të miratohen në kohë.” Ky referim i bërë posaçërisht për dispozitën në fjalë përfaqëson me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Heqja e parashikimit se “subjekti zgjedhor që i ka propozuar kërkon zëvendësimin e tyre” e sjell normën në përputhje me parashikimet e nenit 39 të Kodit Zgjedhor duke imponuar mos ndryshimin e anëtarëve të KQV-ve në minutën e fundit.



Në nenin 26 të vendimit është propozuar ndryshimi i pikës 2 e cila konsiston në përshtatjen sa më cilësore të normës nga pikëpamja e teknikës legjislative si dhe të shmangë procedura teknike të cilat nuk janë të karakterit normativ.

Pika 2 e nenit 27 është riformuluar duke përcaktuar procedurën e mbylljes dhe futjes së zarfit të procesverbalit të vulosjes për zgjedhjet e organeve të vetëqeverisjes vendore dhe procedurën për administrimin e raportit të hapjes së Pajisjes Elektronike të Identifikimit.

Duke qenë se në zgjedhjet për organet e vetëqeverisjes vendore votohet në dy kuti votimi, respektivisht në kutinë e votimit për kryetarë bashkie dhe kuti votimi për këshillin e bashkisë, neni 101, pika 1, shkronja “e” i Kodit Zgjedhor përcakton se origjinali i procesverbalit të vulosjes së kutsisë së votimit mbyllet në zarfin “Zarfi i procesverbalit të Vulosjes” i cili futet në kutinë e votimit për subjektet zgjedhore para fillimit të votimit.

Referuar përvojës së deritanishme si dhe nenit 120 pika 2 e Kodit Zgjedhor që përcakton procedurën e numërimit sipas së cilës “Për çdo bashki, numërimi fillon me votat për kryetarin dhe më pas vijon me numërimin e votave për këshillin përkatës” është përcaktuar se zarfi i procesverbalit origjinal të vulosjes vendoset në kutinë e votimit për kryetarin e bashkisë, ndërsa kopjet e tjera vendosen në kutinë e votimit për këshillin e bashkisë dhe në kutinë e materialeve zgjedhore.

Në çdo rast është përcaktuar se raporti i hapjes së procesit të identifikimit elektronik futet në kutinë e materialeve të votimi, ndërkohë që në aktin ekzistues ky dokument parashikohet të vendoset në kutinë votimit. Arsyeja e rishikimit të kësaj procedurë ka të bëjë me faktin se raporti i hapjes së procesit të identifikimit është dokumenti ekuivalent i listës së zgjedhësve. Dhe duke qenë se ky dokument referuar nenit 113 pika 5 të KZ në përfundim të procesit administrohet në kutinë e materialeve zgjedhore.

Neni 30 i vendimit risillet i përshtatur nga pikëpamja e teknikës legjislative si dhe vendos disa kufizime në lidhje me numrin e tentativave për depozitimin e gjurmëve të gishtërinjve deri në tre herë me qëllim racionalizimin e procesit për shkak se tentativat për skanime të shpeshta mund të jenë të panumërta dhe të pandërprera. Në këtë dispozitë janë eliminuar proceset teknike të cilat janë të ndryshueshme, ndërkohë që normimi i parashikuar në nënpikën “ii” të shkronjës “b” të pikës 1 synojnë një proces teknik që ti rezistojë kohës dhe ti përshtatet azhurnimeve teknike të softuerë.

Neni 31 i vendimit risillet me një procedurë të rishikuar në lidhje me rastet e veçanta të identifikimit elektronik të zgjedhësve. Në pikën 1 të kësaj dispozitë është përcaktuar se lejohen të votojnë në qendrën e votimit zgjedhësit që nuk janë të regjistruar në listën e zgjedhësve dhe që kanë një vendim gjykate që i jep të drejtën të votojnë, anëtarët e KQV-së dhe të KZAZ-së të cilët nuk janë të regjistruar në listën e zgjedhësve të asaj qendre votimit si dhe operatori teknik vetëm nëse ata janë zgjedhës të asaj zone zgjedhore.



Në procesin e riinxhinuar është saktësuar se nëse zgjedhësi qoftë ai zgjedhës që është i regjistruar në listën e zgjedhësve qoftë edhe nëse zgjedhësi nuk është i regjistruar në listën e zgjedhësve të asaj qendre votimi, për të cilët është e pamundur të depozitohen gjurmët e gishtërinjve, zgjedhësi nënshkruan në listën e zgjedhësve, dhe pasi pajisja PEI printon kuponin, zgjedhësi nënshkruan kuponin duke vendosur emër e mbiemër dhe pajiset me fletën e votimit.

Në nenin 38 që normon administrimin e informacionit në ditën e zgjedhjeve, është parashikuar se ky proces nuk kryhet nga sekretari në rast se transmetimi realizohet nga PEI drejtpërdrejtë në KQZ në përputhje me vendimin nr. 7 datë 20.2.2023, të Komisionit rregullator, “Për miratimin e llojit të të dhënave që transmetohen nga pajisja elektronike e identifikimit drejt infrastrukturës së teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) të KQZ dhe rregullat për mënyrën e transmetimit të tyre.”

Gjithashtu në nenin 41, pika 6, është propozuar riformulimi i tij duke e përshtatur administrimin e procesverbalit të mbylljes së votimit për secilin proces zgjedhor. Në vendimin ekzistues përcaktohej procedura vetëm për zgjedhjet e përgjithshme në Kuvend dhe nuk kishte përcaktime për procedurën se ku do të vendosej procesverbali i mbylljes së votimit për zgjedhjet e qeverisjes vendore. Gjithashtu është përcaktuar se raporti i gjeneruar nga PEI automatikisht në mbyllje të procesit do të trajtohet në përputhje me nenin 113 pika 5 e Kodit Zgjedhor duke vendosur raportin e mbylljes së PEI në kutinë e materialeve të votimit. Gjithashtu në respektim të parimeve të mbrojtjes së të dhënave personale është parashikuar që kopje të raportit të mbylljes së identifikimit elektronik t’u jepen anëtarëve të KQV-së dhe vëzhguesve të partive parlamentare të ri printuar pa përfshirë numrin rendor në listë të zgjedhësve.

Për sa më sipër në këtë relacion, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, brenda kompetencave dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, i propozojnë Komisionit Rregullator për shqyrtim dhe miratim, projektvendimin “Për një shtesë në vendimin nr. 2, datë 31.10.2020, të Komisionit Rregullator, “Për llojin dhe karakteristikat teknike që duhet të plotësojnë sistemet dhe pajisjet e identifikimit elektronik të zgjedhësve që prokurohen dhe përdoren në zgjedhje në Republikën e Shqipërisë”.

Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Lealba PELINKU

Ilirjan CELIBASHI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni Rregullator

Data: .1.2023

Nr:

Ora: 00:00

PROJEKTVENDIM

PËR

DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.11, DATË 25.03.2021, TË KOMISIONIT RREGULLATOR, "PËR MËNYRËN E NGRITJES, ORGANIZIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË KOMISIONIT TË QENDRËS SË VOTIMIT DHE ZHVILLIMIT TË ZGJEDHJEVE NË QENDRËN E VOTIMIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 20, pikat 1, shkronjat "a" e "b", dhe 3, nenit 22, pika 3 dhe nenit 36 e vijues, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator

VENDOSI:

I. Në vendimin nr.11, datë 25.03.2021, të Komisionit Rregullator, i ndryshuar, bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

1. Shkronja "d", e pikës 2, të nenit 10, shfuqizohet.
2. Pika 2, e nenit 26, ndryshohet si më poshtë:
 - "2. Operatori teknik i QV-së:
 - a) pasi lidh PEI me rrjetin elektrik, kryen në radhë veprimet si më poshtë:
 - i. shtyp në ekranin e pajisjes kodin e konfigurimit,
 - ii. shtyp në ekranin e pajisjes numrin e qendrës së votimit;
 - b) pas veprimeve sipas shkronjës "a" të këtij paragrafi, në ekranin e PEI shfaqen numri i QV, vendndodhja e QV-së dhe numri i zgjedhësve në listën e zgjedhësve të QV-së;
 - c) anëtarët e KQV-së verifikojnë informacionin që shfaqet në ekranin

Data: .3.2023 Nr:
Ora:



Për një shtesë në vendimin nr.11, datë
25.3.2021, të Komisionit Rregullator

- e PEI sipas shkronjës “b” të këtij paragrafi;
- ç) kur të dhënat që shfaqen në ekranin e PEI janë të njëjta me të dhënat e QV-së, KQV autorizon operatorin teknik të vijoje konfigurimin e PEI për QV-në, duke shtypur butonin “konfirmo”;
- d) operatori teknik i QV-së identifikohet si përdorues i PEI-t, duke shtypur në ekranin e PEI kodin e operatorit.”

3. Pika 2 e nenit 27, ndryshohet si më poshtë:

“2. Sekretari i KQV-së mbyll origjinalin e procesverbalit të vulosjes së kutisë së votimit në zarfin ku është shkruar “ZARF I PROCESVERBALIT TË VULOSJES”, dhe e fut atë në kutinë e votimit para fillimit të procesit të votimit.

Në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, procesverbali i vulosjes së kutisë së votimit hartohet në 3 kopje, ku njëra është origjinale dhe 2 janë kopje të saj. Sekretari i KQV-së mbyll origjinalin e procesverbalit të vulosjes së kutisë së votimit në zarfin ku është shkruar “ZARF I PROCESVERBALIT TË VULOSJES”, dhe e fut atë në kutinë e votimit për kryetarin e bashkisë. Kopjet e procesverbalit të vulosjes së kutisë së votimit mbyllen respektivisht në 2 zarfet ku në secilin është shënuar “ZARF I PROCESVERBALIT TË VULOSJES”, dhe një zarf futet në kutinë e votimit për këshillin e bashkisë dhe tjetri në kutinë e materialeve të votimit.

Raporti i hapjes së procesit të identifikimit elektronik, sipas pikës 3, të nenit 26 të këtij vendimi, futet në kutinë e materialeve të votimit.”.

4. Neni 30 ndryshohet si më poshtë vijon:

“Neni 30

Identifikimi elektronik i zgjedhësit

1. Operatori teknik i QV-së:

- a) skanon me rrëshqitje letërnjoftimin ose pasaportën e zgjedhësit në hapësirën e lexuesit MRZ të PEI. Nëse zgjedhësi është i regjistruar në listën e zgjedhësve të QV-së, dhe nuk është identifikuar më parë, në ekran shfaqen emri, mbiemri, numri personal, fotografia dhe numri rendor i zgjedhësit në listën e zgjedhësve. PEI përmes ngjyrës jeshile në ekran, vërteton se të dhënat e identitetit të zgjedhësit u lexuan me sukses;
- b) orienton zgjedhësin të depozitojë në skanuesin e gjurmëve të gishtërinjve të PEI-t:
 - i. gjurmën e gishtit të madh të dorës së djathtë,
 - ii. të riprovtojë depozitim të gjurmës së gishtit të madh të dorës së djathtë kur në depozitim të parë gjurma nuk u lexua nga PEI deri në 3 herë,

- iii. kur pas kryerjes së veprimeve sipas nënpika “i” dhe “ii”, PEI nuk konfirmon depozitimin e gjurmës së gishtit të madh të dorës së djathtë të zgjedhësit, operatori teknik, i kërkon zgjedhësit të depozitojë gjurmën e gishtërinjve të tjerë sipas orientimeve që shfaqen në ekranin e PEI.
 - c) i dorëzon Kryetarit të KQV-së, dokumentin fizik të printuar nga PEI, për kryerjen e identifikimit elektronik të zgjedhësit i cili përmban:
 - i. numrin e QV-së,
 - ii. datën dhe orën e kryerjes së verifikimit,
 - iii. emrin, mbiemrin, numrin personal dhe fotografinë e zgjedhësit,
 - iv. numrin e zgjedhësit në listën e zgjedhësit të QV-së.
 - ç) Kryetari i KQV-së, administron dokumentin fizik të dorëzuar nga operatori në zarfin ku është shënuar “VËRTETIME TË IDENTIFIKIMIT ELEKTRONIK TË ZGJEDHËSVE”;
 - d) Zgjedhësit i jepet fleta e votimit, pasi ai ka kryer identifikimin elektronik;
 - dh) Përpara se zgjedhësit t’i jepet fleta e votimit ajo vuloset në pjesën e pasme të saj me vulën e KQV-së dhe vulën e kryetarit të KQV-së.
2. Në rastet kur për shkak të dëmtimeve fizike, dokumenti i identitetit të zgjedhësit nuk lexohet nga PEI, operatori teknik i QV-së shtyp në mënyrë manuale të dhënat e zgjedhësit në ekranin e PEI.
 3. Në rast se zgjedhësi nuk pranon të kryejë verifikimin elektronik, atij nuk i jepet fleta e votimit dhe identiteti i tij mbahet shënim në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së.”.

5. Neni 31, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Neni 31

Raste të veçanta të identifikimit elektronik të zgjedhësit

1. KQV, lejon operatorin teknik të QV-së të vijojë me identifikimin e zgjedhësve që paraqiten në qendrën e votimit në rastet e mëposhtme:
 - a) zgjedhësi i cili nuk është i regjistruar në listën e zgjedhësve të qendrës së votimit dhe paraqitet për të votuar me vendim gjykate i cili i jep të drejtë të votojë në atë qendër votimi,
 - b) anëtarët e KQV-së, anëtari i KZAZ i pajisur me vendim të KZAZ-së për të votuar në atë QV, të cilët nuk janë të regjistruar në listën e zgjedhësve të QV-së,
 - c) operatori teknik i QV-së/personi i ngarkuar me detyrë për funksionimin e kamerës, nëse janë zgjedhës të zonës zgjedhore.
2. Në rastet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, operatori teknik i QV-së:
 - a) shtyp në ekranin e PEI butonin “rast i veçantë”,
 - b) skanon dokumentin e identifikimit të zgjedhësit në hapësirën e MRZ,

- c) Pas leximit të të dhënave të zgjedhësit nga PEI, zgjedhësi depoziton gjurmën e gishtit në skanuesin e gjurmëve të gishtërinjve të PEI.
3. Kur përpara KQV-së paraqitet një zgjedhës, i cili nuk është regjistruar në listën e zgjedhësve të QV-së, por është i pajisur me vendim gjykate, i cili i jep të drejtë të votojë në atë qendër votimi, KQV-ja shënon emrin dhe mbiemrin e zgjedhësit, numrin e dokumentit të identifikimit në një regjistr të posaçëm, të cilit i bashkëlidh vendimin e gjykatës. Pas regjistrimit të të dhënave të zgjedhësit të pajisur me vendim gjykate në regjistrin e posaçëm, KQV lejon operatorin teknik të QV-së të kryejë identifikimin elektronik të zgjedhësit.
4. Në rastet kur pavarësisht ndjekjes së procedurave të përcaktuara në nenin 30, pika 1, shkronja “b” të këtij vendimi, është e pamundur të depozitohen gjurmët e gishtërinjve, ndiqet kjo radhë veprimesh:
- a) zgjedhësi nënshkruan në listën e zgjedhësve duke shënuar emrin, mbiemrin dhe firmën,
 - b) pajisja PEI printon kuponin,
 - c) zgjedhësi nënshkruan në kuponin e printuar duke shënuar emrin, mbiemrin dhe firmën,
 - ç) zgjedhësit i dorëzohet fleta e votimit,
 - d) sekretari i QV-së dhe operatori nënshkruajnë në Librin e Protokollit të Mbledhjeve.
5. Sekretari i KQV-së mban shënim në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së rastet kur KQV ka lejuar identifikimin elektronik të zgjedhësit sipas pikës 1 të këtij neni.
6. Në nenin 38, pas pikës 5, shtohet pika 6, me këtë përmbajtje:
“6. Në rast se transmetimi i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, realizohet drejtpërdrejtë nga PEI në KQZ, lloji i të dhënave të transmetuara dhe mënyra e transmetimit do të bëhet në përputhje me vendimin nr. 7, datë 20.2.2023, të Komisionit rregullator, “Për miratimin e llojit të të dhënave që transmetohen nga pajisja elektronike e identifikimit drejt infrastrukturës së teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) të KQZ dhe rregullat për mënyrën e transmetimit të tyre.”.
7. Pika 6, e nenit 41, ndryshohet si më poshtë:
“ 6. Numrat e kodeve të sigurisë, me të cilët do të mbyllet kutia/itë e votimit dhe kutia e materialeve të votimit, shënohen paraprakisht në Procesverbalin për Mbylljen e Votimit dhe në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së. Pasi hidhen të gjitha të dhënat në Procesverbalin

për Mbylljen e Votimit, shënohet ora e saktë e mbylljes së procesverbalit. Originali i Procesverbalit për Mbylljen e Votimit futet në kutinë e votimit, e cila vulozet menjëherë me kodin e pestë të sigurisë, ndërsa kopje të tij futen në kutinë e materialeve të votimit, e cila më pas vulozet me kodet përkatëse të sigurisë.

Në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore origjinali i Procesverbalit për Mbylljen e Votimit futet në kutinë e votimit për kryetar bashkie. Kopje të procesverbalit të mbylljes së votimit futen përkatësisht në kutinë e votimit për këshillin e bashkisë dhe në kutinë e materialeve të votimit.

Raporti i mbylljes, i printuar automatikisht nga PEI sipas përcaktimeve të nenit 40 të këtij vendimi, futet në kutinë e materialeve të votimit.

Kopje të Procesverbalit për Mbylljen e Votimit së bashku me raportin e mbylljes së identifikimit elektronik të zgjedhësve të riprintuar pa përfshirë numrin rendor në listë të zgjedhësve, u jepen anëtarëve të KQV-së dhe vëzhguesve të partive parlamentare.”.

- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- III. Kundër këtij vendimi mund të behet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Ilirjana NANO

Kryetar

Arens ÇELA

Anëtar

Dritan ÇAKA

Anëtar

Helga VUKAJ

Anëtar

Muharrem ÇAKAJ

Anëtar